



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komisioni për ndarjen e Çmimit “Nderi Qytetit”
Nr.01-060/01-6539/25 datë: 25.03.2025



Npi – 01/109 datë: 26.03.2025

Bazuar në Nenet 12.2 shkronja (d), si dhe Nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Nenin 5 dhe Nenin 10, pika 2, të Rregullores Komunale për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet, Npi – 01/173, të datës 27.5.2009, si dhe duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes për formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit “Nderi Qytetit” Npi-01/76 të datës 26.02.2024, Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 26.03.2025, miratoi këtë:

REKOMANDIM

PËR KUVENDIN E KOMUNËS - SHTIME **PËR NDARJEN E ÇMIMIT “NDERI QYTETIT”**

I

Komisioni për ndarjen e Çmimit “Nderi Qytetit”, në mbledhjen e mbajtur më 26.03.2025, unanimisht i Rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratojë vendimin për ndarjen e çmimit “Nderi Qytetit”, për profesorët univerzitar të Suksesshëm, që avansuan Arsimin, Kulturën dhe Artin në rrafshin Kombëtar dhe Ndërkombëtar, si vijon:

1. Prof. Fadil Hysaj - Shtime,
2. Prof. Ismajl Hasani – Shtime, (Post mortum)

II

A r s y e t i m: Komisioni për ndarjen e Çmimit “Nderi Qytetit”, duke u bazuar në kompetencat e veta në bazë të korrnizës ligjore të përshkruar më lartë, dhe pas diskutimeve lidhur me historikun e këtyre dy personaliteteve të merituar të Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Artit i Rekomandon Kuvendin ndarjen e çmimit “Nderi i Qytetit” të Komunës së Shtimes, Profesorit univerzitar z.Fadil Hysaj - Shtime, si dhe Profesorit univerzitar tani të ndjerë z.Ismajl Hasani - Shtime.

III

Rekomandimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të Komisionit, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Komisionit
Faruk Beqa